

Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për Mësimdhënie për Stafin Akademik në Universitetin e Saarland-it, në Gjermani, në Kuadër të Programit Erasmus +

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Saarland-it në Gjermani.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie në fushën e **Drejtësisë** i cili duhet të përfundojë brenda datës 31 Korrik 2017;

Kohëzagjatja e bursave:

- Shkëmbimi i stafit akademik për mësimdhënie (5 ditë);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (120 EUR në ditë për stafin);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim **për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze ose gjermane në nivelin B2 në varësi të programit të mësimdhënies);
- Letër Ftese (nga një profesor në Universitetin e Saarland-it, me të cilin aplikanti kontakton paraprakisht dhe jepet pëlqimi që ai të mbështesë aplikantin gjatë shkëmbimit)
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.doc

**Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kreyntë gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinator i Institucionit Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Afati për aplikim: **2 Qershor 2017**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentat dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori për Marëdhëniet me Jashtë dhe të dërgohen njëkohësisht të skanuara në adresën iro@unitir.edu.al

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!